

**Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal**  
**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2017**  
**(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)**

## **Përmbajtja**

|  |       |
|--|-------|
| Raporti i audituesve të pavarur  | i-iii |
| Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2017: |       |
| Pasqyra e pozicionit financiar   | 1     |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse                               | 2     |
| Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave          | 3     |
| Pasqyra e flukseve monetare  | 4     |
| Shënime për pasqyrat financiare  | 5–20  |



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355 (4) 2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionarët e Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Vullnetar i Pensionit Sigal ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Fondit më 31 dhjetor 2017, të performancës së tij financiare dhe flukseve të tij të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të Fondit më dhe për vitin e mbyllur më më 31 dhjetor 2016, janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi ato pasqyra financiare më 31 maj 2017.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuideojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.



- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Fondit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Fondi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Fatos Beqja  
Auditues Ligjor  
KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 30 prill 2018


**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"***(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e pozicionit financiar**

|  | Shënime | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2016 |
|--|---------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| <b>AKTIVE</b>                            |         |                                      |                                      |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë me to     | 8       | 44,143,683                           | 28,598,591                           |
| Investime në letra me vlerë              | 9       | 833,332,165                          | 645,779,458                          |
| <b>TOTALI I AKTIVEVE</b>                 |         | <b>877,475,848</b>                   | <b>674,378,049</b>                   |
| <b>DETYRIME</b>                          |         |                                      |                                      |
| Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit |         | (2,196,446)                          | (1,687,891)                          |
| <b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>               |         | <b>(2,196,446)</b>                   | <b>(1,687,891)</b>                   |
| <b>VLERA NETO E AKTIVEVE</b>             |         | <b>875,279,402</b>                   | <b>672,690,158</b>                   |
| Numri i kuotave                          |         | 648,164.1806                         | 518,677.8642                         |
| Vlera e asetëve neto për kuote           |         | 1,350.3977                           | 1,296.9325                           |

Këto pasqyra financiare të Fondit i Pensionit Vullnetar SIGAL janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese të Fondit, Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a., më 30 prill 2018 dhe janë firmosur nga:



Naim Hasa  
Administrator



Junida Zavalani  
Drejtoreshë e Financës

**Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”***(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**

|  | Shënime | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2016 |
|--|---------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Të ardhura nga interesat   | 10      | 53,463,235                           | 40,443,837                           |
| <b>Totali i të ardhurave</b>   |         | <b>53,463,235</b>                    | <b>40,443,837</b>                    |
| Shpenzime për tarifë administrimi  |         | (22,764,634)                         | (16,804,094)                         |
| Humbje neto nga kursi i këmbimit   |         | (113,453)                            | (64,656)                             |
| <b>Totali i të ardhurave</b>   |         | <b>(22,878,087)</b>                  | <b>(16,868,750)</b>                  |
| <b>Rritja ne aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave nga operacionet</b> |         | <b>30,585,148</b>                    | <b>23,575,087</b>                    |

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”***(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave**

|   | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2016 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Fitimet neto nga investimet   | 30,585,148                           | 23,575,087                           |
| <b>Rritja në aktivet neto nga aktivitetet operative</b>   | <b>30,585,148</b>                    | <b>23,575,087</b>                    |
| Flukset hyrëse nga anëtarët e fondit  | 197,306,467                          | 192,802,376                          |
| Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit   | (122,923)                            | (975,716)                            |
| Flukset dalëse prej pagesave të pensionit apo tërheqjeve të parakohshme                         | (25,179,448)                         | (11,183,651)                         |
| <b>Rritje neto në aktivet neto nga transaksionet me anëtarët e fondit</b>                       | <b>172,004,096</b>                   | <b>180,643,009</b>                   |
| <b>Rritja totale në aktivet neto</b>  | <b>202,589,244</b>                   | <b>204,218,096</b>                   |
| <b>AKTIVET NETO</b>   |                                      |                                      |
| Në fillim të periudhës  | 672,690,158                          | 468,472,062                          |
| Në fund të periudhës  | 875,279,402                          | 672,690,158                          |
| <b>Numri i kuotave në fillim të periudhës</b>   | <b>518,678</b>                       | <b>376,886</b>                       |
| Kuota të pensionit të emtuara mbi bazën e hyrjeve të kontributeve                               | 148,545                              | 151,344                              |
| Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të fondit të pensionit                   | (92)                                 | (769)                                |
| Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e pagesave të pensionit ose tërheqjeve të parakohshme | (18,967)                             | (8,783)                              |
| <b>Numri i kuotave në fund të periudhës</b>   | <b>648,164</b>                       | <b>518,678</b>                       |

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”***(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e Flukseve të Parasë**

|  | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2016 |
|--|--------------------------------------|--------------------------------------|
| <b>Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operacional</b>                      |                                      |                                      |
| Rritja e aktiveve neto nga aktiviteti operacional                        | 30,585,148                           | 23,575,087                           |
| Rregullime për :   |                                      |                                      |
| Ndryshime në të ardhura të përlogaritura nga investimi në letra me vlerë | (2,763,960)                          | (4,006,642)                          |
| <i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>                     |                                      |                                      |
| Hyrje nga kontribute të anëtarëve  | 197,306,467                          | 192,802,376                          |
| Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit                    | (122,923)                            | (11,183,651)                         |
| Flukset dalëse prej pagesave të pensionit apo tërheqjeve të parakohshme  | (25,179,447)                         | (975,716)                            |
| Rritje në detyrime të tjera  | 508,555                              | 1,687,891                            |
| <b>Rrjedhja neto e parasë nga aktiviteti operacional</b>                 | <b>200,333,840</b>                   | <b>201,899,345</b>                   |
| <b>Rrjedhja e parasë nga aktiviteti investues</b>                        |                                      |                                      |
| Letra me vlerë të maturuara  | -                                    | 13,300,000                           |
| Blerje e letrave me vlerë  | (184,788,748)                        | (232,896,160)                        |
| <b>Rrjedhja neto e parasë nga aktiviteti investues</b>                   | <b>(184,788,748)</b>                 | <b>(219,596,160)</b>                 |
| Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to                      | 15,545,092                           | (17,696,815)                         |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës              | 28,598,591                           | 46,295,406                           |
| <b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës</b>         | <b>44,143,683</b>                    | <b>28,598,591</b>                    |

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”**

### **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)*

---

#### **1. Informacione të përgjithshme**

Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal (“Fondi”) është një fond kontributësh i aprovuar për të operuar si i tillë, sipas vendimit nr. 51, datë 30 Mars 2011 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”).

##### ***Aktiviteti Kryesor***

Objekti i Fondit është të gjenerojë rritje afatmesme dhe afatgjatë të rëndësishme të kapitalit dhe ka si synim të arrijë këtë objektiv duke tregtuar një portofol të letrave me vlerë qeveritare të qeverisë shqiptare. Fondi është nën administrimin e “Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a.” (“Shoqëria Administruese”), liçensuar nga AMF më 30 Mars 2011.

Fondi i pensionit bashkë-zotërohet nga të gjithë kontribuesit e fondit, nën një bashkëpronësi të ndarë, që përfaqësohet në kuota të fondit të pensionit. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë proporcionale mbi aktivet e fondit të pensionit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare caktoi dhe aprovoi Tirana Bank sh.a. si Depozitar të Fondit të Pensionit. Shoqëria Administruese dhe Depozitari kërkohet të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit prej aktiveve, veprimeve dhe regjistrimeve të tyre. Për këtë arsye regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit dhe Shoqërisë Administruese mbahen të ndara dhe pasqyrat financiare respektive përgatiten gjithashtu të ndara.

##### ***Adresa e regjistruar***

Zyra qendrore e Shoqërisë Administruese është në: Bulevardin “Zogu I” Rr.nr.1, Tiranë, Shqipëri.

#### **2. Baza e kontabilitetit**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Detajet e politikave kontabël të Fondit janë të përfshira në Shënimin 4.

#### **3. Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e fondit.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël**

##### **(a) Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

##### **(b) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë që maten me koston historike në monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit në përgjithësi njihen në fitim ose humbje.

## **Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"**

### **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)*

---

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(c) Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbret pagesat dhe arkëtimet e ardhshme në të holla nëpërmjet jetës së pritshme të aktivitetit ose pasivitetit financiar (ose, sipas rastit, një periudhe më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose pasivitetit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit financiar dhe mund të rishikohet në bazë të kushteve kontraktuale. Norma efektive e interesit për detyrimet financiare përcaktohet në njohjen fillestare dhe rishikohet më vonë në bazë të kushteve kontraktuale.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranuar, kostot e transaksionit dhe uljet ose primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, lëshimit ose shitjes së një aktivi ose pasivi financiar.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë interesin mbi aktivitetet dhe detyrimet financiare me koston e amortizuar në bazë të normës efektive të interesit.

##### **(d) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të ofruara nga Fondi. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi që shërbimet e lidhura janë marrë duke qenë tarifa e administrimit të Fondit. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

##### **(e) Pagesat e qirasë**

Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

##### **(f) Tatimi mbi fitimin**

Sipas sistemit aktual tatimor në Shqipëri, Fondi është i përjashtuar nga pagesa e tatimit mbi fitimin. Megjithatë, të ardhurat nga interesi të marra nga Fondi janë subjekt i tatimit në burim.

Fondi ka përcaktuar që interesi dhe gjobat në lidhje me tatimin mbi fitimin nuk plotësojnë përkufizimin e një tatimi mbi fitimin. Prandaj, ato trajtohen sipas *SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente*.

## Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

#### 4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

##### (g) Instrumentet financiare

Fondi klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera aktivet e mbajtura deri në maturim dhe detyrimet financiare jo-derivative në detyrme të tjera.

##### (i) *Aktivet financiare dhe detyrimet financiare jo-derivative - Njohja dhe çregjistrimi*

Fondi fillimisht një llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato kanë origjinën.

Fondi çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ose as nuk transferon dhe as ruan në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin mbi aktivin e transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Fondi njihen si një aktiv ose pasiv i veçantë.

Fondi çregjistron një pasiv financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Fondi aktualisht ka një të drejtë të detyrueshme ligjërish për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë pasuri dhe shlyer detyrimin në të njëjtën kohë.

##### (ii) *Aktivet financiare jo-derivative - Matja*

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### (iii) *Detyrimet financiare jo-derivative - Matja*

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### (iv) *Netimi*

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë netuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Fondi ka të drejtën ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti i Fondit.

#### **4 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(g) Instrumentet financiarë (vazhdim)**

###### *(v) Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose të paguar për të transferuar një pasiv në një transaksion të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në parimin, ose në mungesë të saj, tregu më i favorshëm në të cilin Fondi ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e mos-performancës. Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Fondi konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

###### *(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Në çdo datë raportimi, Fondi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare janë të zhvlerësuara kur evidencat objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivit që mund të maten me besueshmëri.

Prova objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë vonesat ose vonesat nga një huamarrës, ristrukturimin e një huaje ose avancimi me kushte që Fondi nuk do ta konsideronte ndryshe, tregues se huamarrësi do të hyjë në falimentim ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup aktivesh të tilla si ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësve ose kushtet ekonomike që lidhen me dështimet në grup.

Fondi konsideron dëshmi të zhvlerësimit në të dy nivelet kolektive dhe specifike. Kreditë në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku huamarrësit me karakteristika të ngjashme të kredisë. Kreditë në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmive objektive të një niveli rreziku që tejkalojnë nivelin historik të rrezikut të kredive të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe delikuencës. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(h) Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat afatgjata me maturim fillestar më shumë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat në banka si nënkategori e huave dhe aktiveve financiare të arkëtueshme.

##### **(i) Depozitat me afat**

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

##### **(j) Investime në letrat me vlerë**

Investimet në letrat me vlerë janë investime borxhi që Fondi ka synimin dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim dhe klasifikohen si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synojnë të mbahen deri në maturim, maten më pas me koston e amortizuar, minus provizioni për zhvlerësim në vlerë. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje.

##### **(k) Njësia e investuese dhe konsolidimi**

Fondi ka investitorë të shumëfishtë dhe mban investime të shumta. Pasqyrat financiare të Fondit nuk janë të konsoliduara me Shoqërinë e Administrimit. Fondi konsiderohet të përmbushë përkufizimin e një njësie investuese sipas SNRF 10 si ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

(a) Fondi ka marrë fonde me qëllim të sigurimit të investitorëve me shërbime profesionale të administrimit të investimeve.

(b) Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u komunikohet drejtpërdrejtë investitorëve, është investimi për vlerësime të kapitalit dhe të ardhurat nga investimet.

(c) Investimet maten dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë (përveç atyre të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim).

##### **(l) Vlera e Aktiveve Neto**

Aktivet neto përfaqësojnë kontributet në para dhe kthimin nga investimi në këto kontribute pa pagesat dhe komisionet për Shoqërinë Administruese të kontribuuesve të fondit të pensioneve të konvertuara në kuota. Çdo kuotë përfaqëson një pjesë proporcionale të pronësisë mbi çdo pasuri të Fondit. Kuotat i referohen shumës totale të kontributeve të ndara me vlerën e njësisë kontabël.

##### **(m) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara**

Disa Standarde të reja, ndryshime të Standardeve dhe Interpretimeve ekzistuese janë në fuqi për periudha vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2017; gjithsesi, nuk janë zbatuar nga Fondi në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

##### **SNRF 9 Instrumentet financiare**

SNRF 9, i publikuar në korrik 2014 zëvendëson interpretimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin interpretime të rishikuara në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së prituri të kreditit për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të kontabilitetit të mbrojtjes. SNRF 9 është efektiv për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018 me mundësinë e aplikimit të mëhershëm. Fondi ka nisur procesin e zbatimit të SNRF 9 dhe drejtimi nuk pret që standardi i ri, kur të aplikohet fillimisht, të ketë ndikim material në pasqyrat financiare.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(m) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara (vazhdim)**

###### **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendëson standardet ekzistuese për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë IAS 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Konsumatorëve. SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Fondit, Drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Fondit. Koha dhe matja e të ardhurave të Fondit nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Fondit dhe llojit të të ardhurave që ajo realizon.

###### **SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira, KIS-15 Qiratë Operative - Stimujt dhe KIS-27 Vlerësimi i Përbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje.

Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Miratimi i hershëm është i lejuar për subjektet që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njih një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivit bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësi do të vazhdojë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative.

Fondi ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Fondit më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Fondit në atë datë, vlerësimin më të fundit të Fondit nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Fondi do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja. Drejtimi nuk pret që standardi i ri, kur të aplikohet fillimisht, të ketë ndikim material në pasqyrat financiare. Më 31 dhjetor 2017, Fondi nuk është palë në një marrëveshje kontraktuale që do të ishte objekt i SNRF 16.

###### **Standarde të tjera**

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë:

- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28;
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2);
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40);
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);
- KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj;
- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23);
- Ndryshimet, Shkurtime ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19)

## **5. Administrimi i rrezikut financiar**

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë në një sërë rreziqesh financiare: rreziku i tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit me vlerë të drejtë, rrezikun e normës së interesit të fluksit monetar dhe rrezikun e çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Fondi është gjithashtu i ekspozuar ndaj rreziqeve operacionale të tilla si rreziku i ruajtjes. Rreziku i ruajtjes është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura të shkaktuara nga falimentimi ose neglizhenca e mbajtësit. Megjithatë ekziston një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura, në rast të dështimit të tij, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të zhvlerësohet përkohësisht.

Programi i përgjithshëm i administrimit të rrezikut të Fondit synon të maksimizojë kthimet për nivelin e rrezikut ndaj të cilit Fondi është i ekspozuar dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Fondit. Funkzioni i administrimit të rrezikut në kuadër të Fondit kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operacionale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e çmimeve të tjera), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Objektivat primare të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi se ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet e administrimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Fondi nuk përdor instrumente financiare derivative për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

### **Kuadri i administrimit të rrezikut**

Aktiviteti i Fondit monitorohet dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA. Sh.a ("Shoqëria e Administrimit"). Në pajtim me ligjin nr. 10197 datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Shoqëria e Administrimit duhet të krijojë një funksion të veçantë të dedikuar për administrimin e rrezikut. Aksionaret e Shoqërisë së Administrimit emëruan Këshillin Administrativ të Fondit, i cili përbëhet nga pesë anëtarë:

- Z. Adrian Totokoçi, Kryetar
- Z. Klement Mersini, Anëtar
- Z. Naim Hasa, Anëtar
- Z. Abdyl Sarja, Anëtar
- Z. Edvin Hoxhaj, Anëtar

Kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative; aprovimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit. Këshilli i administrimit është i angazhuar të sigurojë që Shoqëria Administruese vepron në përputhje me ligjin dhe standardet e kontabilitetit. Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e Komitetit Investues si më poshtë:

- Z. Naim Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese.
- Z. Klement Mersini, Drejtor Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Z. Blodin Cuci, Drejtor i Alokimit Strategjik të Aseteve në Bankën e Shqipërisë
- Znj. Esmeralda Shehaj, Pedagogë e Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe Konsulente mbi investimet dhe menaxhimin e rrezikut.



## **Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"**

### **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)*

---

## **5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **Kuadri i administrimit të rrezikut**

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë alokimin dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riskut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimum të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

### **Depozituesi**

Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", mjetet e fondit të pensionit, duke përfshirë mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, duhet të mbahen me një depozitë të vetme, në një bankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë. Për sigurimin e shërbimeve të mbajtjes siç është miratuar nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare për rolin depozitues.

Shoqëria Administruese e Fondit ka marrëveshje me Tirana Bank sh.a. Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Banka ofron shërbime në lidhje me ruajtjen, depozitimin dhe besimin për aktivet e fondit.

Funksionet e depozitimit përfshijnë llogaritjen e vlerës së aktiveve neto të fondit të pensionit dhe raportimin në baza mujore të Shoqërisë Administruese, duke siguruar që të ardhurat nga transaksionet që përfshijnë aktivet e fondit të pensionit shpërndahen / kapitalizohen tek kontribuuesit e fondit të pensionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke informuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo çështje që mund të përbëjë një shkelje të legjislacionit ose kërcënimin e interesave të anëtarëve.

Tirana Bank është një filial i Piraeus Bank SA, Greqi. Piraeus Bank SA është vlerësuar me C nga S & P me një perspektivë të qëndrueshme. Tirana Bank vetë nuk është vlerësuar.

### **5.1 Rreziku i tregut**

Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe pasivet që sjellin interesa dhe (c) instrumentet e kapitalit neto, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut. Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut paraqitet më poshtë dhe ato bazohen në një ndryshim në një faktor, duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj.

**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)****a) Rreziku i monedhës**

Fondi kryen transaksione në valutë vendore dhe të huaja; prandaj paraqiten ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Risku i kursit të këmbimit paraqitet si vlera e transaksioneve të ardhshme dhe aktivet monetare të njohura dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të tjera luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve / detyrimeve. Norma e aplikueshme zyrtare e Bankës (Lek në njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishte si më poshtë:

| në Lek | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|--------|-----------------|-----------------|
| USD    | 111.10          | 128.17          |
| Euro   | 132.95          | 135.23          |

Aktivt financiarë ose detyrimet financiarë në monedha të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa më poshtë:

**31 dhjetor 2017**

| Aktivt                                | në Lek             | në EUR           | Totali             |
|---------------------------------------|--------------------|------------------|--------------------|
| Mjete monetare në arkë dhe në bankë   | 35,697,187         | 8,446,496        | <b>44,143,683</b>  |
| Investime në letra me vlerë           | 833,332,165        | -                | <b>833,332,165</b> |
| <b>Totali i aktiveve financiare</b>   | <b>869,029,352</b> | <b>8,446,496</b> | <b>877,475,848</b> |
| <b>Totali i detyrimeve financiare</b> | <b>(2,196,446)</b> | <b>-</b>         | <b>(2,196,446)</b> |
| <b>Pozicioni neto</b>                 | <b>866,832,906</b> | <b>8,446,496</b> | <b>875,279,402</b> |

**31 dhjetor 2016**

| Aktivt                                | në Lek             | në EUR           | Totali             |
|---------------------------------------|--------------------|------------------|--------------------|
| Mjete monetare në arkë dhe në bankë   | 24,727,693         | 3,870,898        | <b>28,598,591</b>  |
| Investime në letra me vlerë           | 645,779,458        | -                | <b>645,779,458</b> |
| <b>Totali i aktiveve financiare</b>   | <b>670,507,151</b> | <b>3,870,898</b> | <b>674,378,049</b> |
| <b>Totali i detyrimeve financiare</b> | <b>(1,687,891)</b> | <b>-</b>         | <b>(1,687,891)</b> |
| <b>Pozicioni neto</b>                 | <b>668,819,260</b> | <b>3,870,898</b> | <b>672,690,158</b> |

**b) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Periudha për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 Fondi nuk ka detyrime të rëndësishme me interes dhe prandaj rreziku i normës së interesit lidhet vetëm me aktivet financiare me interes.

Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesit janë të lidhura anasjelltas. Nga ana tjetër, një mjedis i ulët i normës së interesit e bën të vështirë për Fondin që të sigurojë një normë të mjaftueshme të brendshme të kthimit. Rritja / ulja paralele e kurbës së yield-eve me 100 bp për portofolin e titujve me të ardhura fikse do të rriste / ulte vlerën neto të aktiveve të Fondit për lek (8,523,410) (2016: 6,772,819).

**Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”**

**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)*

**5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)**

**c) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer detyrimet e veta në mënyrën e duhur. Fondi është i ekspozuar ndaj shlyerjes mujore të pagesës periodike të pensioneve dhe pagesave për tërheqje të hershme nga fondit i pensionit. Politika e Shoqërisë së Administrimit është që të investojë shumicën e aktiveve të saj në investime që do të mbahen deri në maturim. Për tërheqje të hershme nga Fondi, Shoqëria e Administrimit ka caktuar afate kohore për njoftimin e tërheqjes, të tilla si 30 ditë. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| 31 dhjetor 2017                        | Vlera kontabël     | Flukset kontraktuale të paskontuara | Më pak se një muaj | 1 deri në 3 muaj  | 3 muaj deri në një vit | 1 deri në 5 vjet   | Më shumë se 5 vjet   |
|--|--------------------|-------------------------------------|--------------------|-------------------|------------------------|--------------------|----------------------|
| <b>Aktivët financiarë</b>              |                    |                                     |                    |                   |                        |                    |                      |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre | 44,143,683         | 44,149,616                          | 44,149,616         | -                 | -                      | -                  | -                    |
| Investime në letra me vlerë            | 833,332,165        | 1,170,106,266                       | -                  | 20,067,229        | 109,115,838            | 441,891,285        | 599,031,913          |
| <b>Totali i aktiveve financiare</b>    | <b>877,475,848</b> | <b>1,214,255,882</b>                | <b>44,149,616</b>  | <b>20,067,229</b> | <b>109,115,838</b>     | <b>441,891,285</b> | <b>599,031,913</b>   |
| <b>Detyrimet financiare</b>            | (2,196,446)        | (2,196,446)                         | (2,196,446)        | -                 | -                      | -                  | -                    |
| <b>Hendeku neto i maturimit</b>        | <b>875,279,402</b> | <b>1,212,059,436</b>                | <b>41,953,170</b>  | <b>20,067,229</b> | <b>109,115,838</b>     | <b>441,891,285</b> | <b>599,031,913</b>   |
| <b>Efekti i akumuluar</b>              |                    |                                     | <b>41,953,170</b>  | <b>62,020,399</b> | <b>171,136,237</b>     | <b>613,027,523</b> | <b>1,212,059,436</b> |
| 31 dhjetor 2016                        | Vlera kontabël     | Flukset kontraktuale të paskontuara | Më pak se një muaj | 1 deri në 3 muaj  | 3 muaj deri në një vit | 1 deri në 5 vjet   | Më shumë se 5 vjet   |
| <b>Aktivët financiarë</b>              |                    |                                     |                    |                   |                        |                    |                      |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre | 28,598,591         | 28,598,591                          | 28,598,591         | -                 | -                      | -                  | -                    |
| Investime në letra me vlerë            | 645,779,458        | 942,956,900                         | 8,470,750          | 6,160,385         | 32,734,765             | 442,025,350        | 453,565,650          |
| <b>Totali i aktiveve financiare</b>    | <b>674,378,049</b> | <b>971,555,491</b>                  | <b>37,069,341</b>  | <b>6,160,385</b>  | <b>32,734,765</b>      | <b>442,025,350</b> | <b>453,565,650</b>   |
| <b>Detyrimet financiare</b>            | (1,687,891)        | (1,687,891)                         | (1,687,891)        | -                 | -                      | -                  | -                    |
| <b>Hendeku neto i maturimit</b>        | <b>672,690,158</b> | <b>969,867,600</b>                  | <b>35,381,450</b>  | <b>6,160,385</b>  | <b>32,734,765</b>      | <b>442,025,350</b> | <b>453,565,650</b>   |
| <b>Efekti i akumuluar</b>              |                    |                                     | <b>35,381,450</b>  | <b>41,541,835</b> | <b>74,276,600</b>      | <b>516,301,950</b> | <b>969,867,600</b>   |

## **5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **5.2 Rreziku i kredisë**

Emetuesit e instrumenteve të borxhit të përfshira në portofol mund të dështojnë në pagesën e interesit dhe të principalit. Përkeqësimi i cilësisë së kredisë nënkupton gjithashtu uljen e vlerës së tregut dhe likuiditetin për instrumentin bazë. Një rritje në përhapjen e kredisë mund të ulë gjithashtu vlerën e tregut të instrumenteve të borxhit që çojnë në një rënie të përgjithshme të vlerës neto të aktiveve për fondin.

Alokimi strategjik i mjeteve është në përputhje me rregulloren "Aktivet e lejuara, kufizimet në shumën maksimale të investimeve në fondet e pensione" të datës 18 tetor 2010. Këshilli i Investimeve ka investuar ekskluzivisht në instrumentet e borxhit të lëshuara nga Qeveria Shqiptare. Qeveria shqiptare është vlerësuar me B1 me një opinion të qëndrueshëm nga Moody's. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë sipas klasës së aktiveve është pasqyruar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

|  | <b>31 dhjetor 2017</b> | <b>31 dhjetor 2016</b> |
|--|------------------------|------------------------|
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre             | 44,143,683             | 28,598,591             |
| Investime në letra me vlerë                        | 833,332,165            | 645,779,458            |
| <b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</b> | <b>877,475,848</b>     | <b>674,378,049</b>     |

### **Politika e investimit**

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Vullnetar të Pensionit Sigal bazohet në legjisllacionin dhe rregulloret e nxjerra nga AMF, si dhe politikat e brendshme të investimit nga ana e Shoqërisë Administruese, të propozuara nga Komiteti i Investimeve dhe të miratuara nga Bordi Drejtues i Shoqërisë Administruese.

Shoqëria administruese është e detyruar të veprojë në përputhje me Rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondeve të pensione" të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin e Bordit Nr. 1 të datës 28 janar 2010, të ndryshuar me Vendimi i Bordit Nr. 109 i datës 18 tetor 2010.

Bazuar në këtë rregullore, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet në vijim:

- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat e tjera me të lëshuara dhe të garantuara nga Qeveria e Shqipërisë;
- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë të lëshuara dhe të garantuara nga një shtet anëtar i BE ose OECD ose nga bankat qendrore përkatëse;
- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat me vlerë të lëshuara dhe të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- Depozita bankare të licencuara me një maturim më pak se 12 muaj;
- Obligacionet e klasifikuara si BBB ose më të larta sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më të larta sipas Moody's ose BBB (-) ose më të larta sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);

Aksionet ose njësitë e fondeve të investimeve të licencuara në një shtet anëtar të BE dhe objektivi i vetëm i të cilit është investimi në indekset e mëposhtme: CAC 40, DAX, FTSE 100, S & P 500, Mesatarja industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (japoneze) , Të gjitha Ordinarët (Australian) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacionet, bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tjera të lëshuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE.

## **6. Vlerësimet dhe gjykime kritike të kontabilitetit**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur.

**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***7. Paraqitja me vlerën e drejtë**

Fondi duhet të klasifikojë, për qëllim paraqitjeje, matjet me vlerë të drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që të reflektojë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes.

**Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar në treg ose çmimet e kuotuar për instrumente financiare të tregtuara në tregje aktive. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare, vlera e drejtë përcaktohet me teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika në vlerë aktuale neto, metodën e fluksit të skontuar të parasë, krahasime me instrumente të ngjashme për të cilët ekzistojnë çmime të matshme tregu, dhe modele vlerësimi.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave gjatë matjes, e cila shpjegohet si më poshtë:

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të buzara në të dhëna të vrojtueshme, në mënyrë direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur çmime tregu të kuotura në tregje aktive për instrumente të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime të kuotuar tregu ose çmime kuotacionesh nga tregtarët. Për instrumente financiare që tregtohen rrallë dhe nuk ka transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon grada të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet e çmimeve dhe risqe të tjera që influencojnë instrumentin specifik.

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiarë që nuk maten me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016

|  | <b>Të mbajtura deri<br/>në maturim</b> | <b>Kredi dhe të<br/>arkëtueshme</b> | <b>Vlera<br/>kontabël</b> | <b>Vlera e<br/>drejtë</b> |
|--|--|-------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| <b>31 dhjetor 2017</b>                 |  |                                     |                           |                           |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre | 35,601,463                             | 8,542,220                           | 44,143,683                | 44,143,683                |
| Investime në letra me vlerë            | 833,332,165                            | -                                   | 833,332,165               | 915,476,320               |
| <b>31 dhjetor 2016</b>                 |  |                                     |                           |                           |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre | -                                      | 28,598,591                          | 28,598,591                | 28,598,591                |
| Investime në letra me vlerë            | 645,779,458                            | -                                   | 645,779,458               | 707,727,764               |

**Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë gjendjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e drejtë konsiderohet shuma e arkëtueshme në datën e raportimit.

**Investime në letra me vlerë**

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Vlera e drejtë për këto letra me vlerë është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të skontuara bazuar në një kurbë korrente të yield-eve të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim.

**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbehen si më poshtë:

|                           | <b>31 dhjetor 2017</b> | <b>31 dhjetor 2016</b> |
|---------------------------|------------------------|------------------------|
| Mjete monetare në arkë    | -                      | -                      |
| Mjete monetare në bankë   | 44,143,683             | 28,598,591             |
| <i>në monedhë të huaj</i> | <i>95,724</i>          | <i>24,727,693</i>      |
| <i>në lek</i>             | <i>44,047,959</i>      | <i>3,870,898</i>       |
| <b>Totali</b>             | <b>44,143,683</b>      | <b>28,598,591</b>      |

Mjetet në bankë në lekë përfshijnë depozitat afatshkurtra të kryera për periudha të ndryshme midis një dite dhe tre muajsh, në varësi të kërkesave të menjëhershme për mjete monetare të Fondit, dhe fitojnë interes në normat përkatëse të depozitave afatshkurtra.

**9. Investime në letra me vlerë**

| <b>Obligacione Qeveritare</b> | <b>31 dhjetor 2017</b> | <b>31 dhjetor 2016</b> |
|-------------------------------|------------------------|------------------------|
| Çmimi i blerjes               | 822,200,000            | 635,500,000            |
| Zbritje                       | (5,457,605)            | (2,935,565)            |
| Primi                         | 643,975                | 31,724                 |
| Interesi e përlogaritur       | 15,945,795             | 13,183,299             |
| <b>Totali</b>                 | <b>833,332,165</b>     | <b>645,779,458</b>     |

Investimet në obligacionet e Qeverisë Shqiptare të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim arritën në 833,332,165 Lek me maturim mesatar prej 7.69 vitesh dhe yield-e duke filluar nga 4.05% në 9.74% në vit. (2016: 645,779,458 lekë, maturimi mesatar prej 5.26 vite dhe yield-e duke filluar nga 4.89% në 9.52% në vit).

**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)****Obligacione Qeveritare****31 dhjetor 2017**

| <b>Data e blerjes</b> | <b>Data e maturimit</b> | <b>Vlera nominale</b> | <b>Çmimi i blerjes</b> | <b>Yield/ Kuponi</b> | <b>Kostoja e amortizuar më 31 dhjetor 2017</b> |
|-----------------------|-------------------------|-----------------------|------------------------|----------------------|--|
| 08.02.2013            | 08.02.2018              | 5,400,000             | 5,400,000              | 9.04%                | 5,589,454                                      |
| 07.05.2013            | 07.05.2018              | 21,700,000            | 21,700,000             | 8.63%                | 21,979,433                                     |
| 09.08.2013            | 09.08.2018              | 26,400,000            | 26,400,000             | 7.84%                | 27,205,876                                     |
| 12.12.2013            | 12.12.2018              | 5,600,000             | 5,600,000              | 6.70%                | 5,620,375                                      |
| 05.08.2014            | 08.05.2019              | 9,500,000             | 9,500,000              | 6.76%                | 9,594,554                                      |
| 13.08.2014            | 18.08.2019              | 14,100,000            | 14,100,000             | 6.72%                | 14,460,159                                     |
| 11.10.2014            | 10.11.2019              | 6,000,000             | 6,000,000              | 6.72%                | 6,056,645                                      |
| 18.03.2013            | 18.03.2020              | 19,000,000            | 19,000,000             | 9.74%                | 19,519,598                                     |
| 04.05.2015            | 04.05.2020              | 10,000,000            | 10,000,000             | 6.55%                | 10,102,913                                     |
| 13.06.2013            | 13.06.2020              | 13,000,000            | 13,000,000             | 9.32%                | 13,062,559                                     |
| 16.12.2013            | 16.12.2020              | 36,900,000            | 36,900,000             | 7.58%                | 37,021,728                                     |
| 17.03.2014            | 17.03.2021              | 12,500,000            | 12,500,000             | 7.78%                | 12,777,361                                     |
| 16.06.2014            | 16.06.2021              | 8,000,000             | 8,000,000              | 7.81%                | 8,027,469                                      |
| 15.09.2014            | 15.09.2021              | 8,700,000             | 8,700,000              | 7.91%                | 8,899,533                                      |
| 08.11.2016            | 08.11.2021              | 40,000,000            | 40,000,000             | 5.32%                | 40,306,585                                     |
| 09.12.2014            | 09.12.2021              | 6,500,000             | 6,500,000              | 7.99%                | 6,532,442                                      |
| 16.06.2015            | 16.06.2022              | 19,800,000            | 19,800,000             | 7.95%                | 19,869,409                                     |
| 16.09.2015            | 16.09.2022              | 18,000,000            | 18,000,000             | 7.92%                | 18,409,721                                     |
| 16.03.2016            | 16.03.2023              | 500,000               | 531,724                | 4.05%                | 527,009  |
| 15.09.2016            | 15.09.2023              | 22,000,000            | 22,000,000             | 4.95%                | 22,318,309                                     |
| 24.01.2014            | 24.01.2024              | 10,000,000            | 10,000,000             | 9.45%                | 10,406,469                                     |
| 25.04.2014            | 25.04.2024              | 7,700,000             | 7,700,000              | 9.55%                | 7,831,691                                      |
| 24.10.2014            | 24.10.2024              | 26,700,000            | 26,700,000             | 9.46%                | 27,158,669                                     |
| 23.01.2015            | 23.01.2025              | 32,200,000            | 32,200,000             | 9.45%                | 33,516,746                                     |
| 24.07.2015            | 24.07.2025              | 67,500,000            | 67,500,000             | 9.09%                | 70,141,299                                     |
| 23.10.2015            | 23.10.2025              | 14,500,000            | 14,500,000             | 8.99%                | 14,740,648                                     |
| 18.01.2016            | 18.01.2026              | 65,500,000            | 65,500,000             | 8.05%                | 67,859,921                                     |
| 15.07.2016            | 15.07.2016              | 32,000,000            | 32,000,000             | 5.88%                | 32,862,152                                     |
| 07.10.2016            | 07.10.2026              | 15,800,000            | 15,800,000             | 6.81%                | 16,047,554                                     |
| 15.09.2016            | 15.09.2023              | 60,000,000            | 57,064,435             | 6.07%                | 57,740,696                                     |
| 09.01.2017            | 09.07.2017              | 20,000,000            | 20,000,000             | 7.33%                | 20,687,121                                     |
| 03.04.2017            | 03.04.2027              | 48,700,000            | 48,700,000             | 6.55%                | 49,471,313                                     |
| 01.07.2017            | 01.07.2027              | 24,000,000            | 24,000,000             | 5.46%                | 24,109,871                                     |
| 09.01.2017            | 09.07.2017              | 11,000,000            | 11,612,250             | 7.01%                | 11,599,971                                     |
| 03.04.2017            | 03.04.2027              | 41,000,000            | 39,499,489             | 7.12%                | 40,129,599                                     |
| 01.07.2017            | 01.07.2027              | 42,000,000            | 40,978,476             | 5.94%                | 41,147,313                                     |
|                       |                         | <b>822,200,000</b>    | <b>817,386,374</b>     |                      | <b>833,332,165</b>                             |

**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"**

**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)*

**9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)**

**31 dhjetor 2016**

| Data e blerjes | Data e maturimit | Vlera nominale     | Çmimi i blerjes    | Yield/ Kuponi | Kostoja e amortizuar më 31 dhjetor 2016 |
|----------------|------------------|--------------------|--------------------|---------------|---|
| 08.02.2013     | 08.02.2018       | 5,400,000          | 5,400,000          | 8.89%         | 5,591,944                               |
| 18.03.2013     | 18.03.2020       | 19,000,000         | 19,000,000         | 9.52%         | 19,520,353                              |
| 07.05.2013     | 07.05.2018       | 21,700,000         | 21,700,000         | 8.45%         | 21,978,158                              |
| 13.06.2013     | 13.06.2020       | 13,000,000         | 13,000,000         | 9.12%         | 13,063,873                              |
| 09.08.2013     | 09.08.2018       | 26,400,000         | 26,400,000         | 7.70%         | 27,208,365                              |
| 12.12.2013     | 12.12.2018       | 5,600,000          | 5,600,000          | 6.60%         | 5,620,785                               |
| 16.12.2013     | 16.12.2020       | 36,900,000         | 36,900,000         | 7.45%         | 37,024,989                              |
| 24.01.2014     | 24.01.2024       | 10,000,000         | 10,000,000         | 9.25%         | 10,407,296                              |
| 17.03.2014     | 17.03.2021       | 12,500,000         | 12,500,000         | 7.64%         | 12,777,655                              |
| 25.04.2014     | 25.04.2024       | 7,700,000          | 7,700,000          | 9.34%         | 7,832,088                               |
| 08.05.2014     | 08.05.2019       | 9,500,000          | 9,500,000          | 6.65%         | 9,594,248                               |
| 16.06.2014     | 16.06.2021       | 8,000,000          | 8,000,000          | 7.67%         | 8,027,965                               |
| 13.08.2014     | 13.08.2019       | 14,100,000         | 14,100,000         | 6.62%         | 14,460,707                              |
| 15.09.2014     | 15.09.2021       | 8,700,000          | 8,700,000          | 7.77%         | 8,900,242                               |
| 24.10.2014     | 24.10.2024       | 26,700,000         | 26,700,000         | 9.25%         | 27,160,287                              |
| 10.11.2014     | 10.11.2019       | 6,000,000          | 6,000,000          | 6.62%         | 6,056,991                               |
| 09.12.2014     | 09.12.2021       | 6,500,000          | 6,500,000          | 7.85%         | 6,532,949                               |
| 23.01.2016     | 23.01.2025       | 32,200,000         | 32,200,000         | 9.25%         | 33,519,833                              |
| 05.05.2016     | 04.05.2020       | 10,000,000         | 10,000,000         | 6.45%         | 10,103,165                              |
| 16.06.2016     | 16.06.2022       | 19,800,000         | 19,800,000         | 7.80%         | 19,870,459                              |
| 24.07.2016     | 24.07.2025       | 67,500,000         | 67,500,000         | 8.90%         | 70,145,153                              |
| 16.09.2016     | 16.09.2022       | 18,000,000         | 18,000,000         | 7.78%         | 18,410,928                              |
| 23.10.2016     | 23.10.2025       | 14,500,000         | 14,500,000         | 8.80%         | 14,741,418                              |
| 08.11.2017     | 08.11.2021       | 40,000,000         | 40,000,000         | 5.25%         | 40,307,726                              |
| 16.03.2017     | 16.03.2023       | 500,000            | 531,724            | 4.9%          | 531,512                                 |
| 15.09.2017     | 15.09.2023       | 22,000,000         | 22,000,000         | 4.89%         | 22,319,061                              |
| 18.01.2017     | 18.01.2026       | 65,500,000         | 65,500,000         | 7.9%          | 67,864,772                              |
| 15.07.2017     | 15.07.2026       | 32,000,000         | 32,000,000         | 5.8%          | 32,863,186                              |
| 07.10.2017     | 07.10.2026       | 15,800,000         | 15,800,000         | 6.7%          | 16,048,231                              |
| 15.09.2017     | 15.09.2023       | 60,000,000         | 57,064,435         | 4.89%         | 57,295,119                              |
|                |                  | <b>635,500,000</b> | <b>632,596,159</b> |               | <b>645,779,458</b>                      |

**10. Të ardhura nga interesi i letrave me vlerë**

|  | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|--|--|--|
| Të ardhura nga bonot e thesarit                    | 53,461,772                             | 40,321,147                             |
| Të ardhura nga interesi nga depozitat afatshkurtra | 1,463                                  | 122,690                                |
| <b>Totali</b>                                      | <b>53,463,235</b>                      | <b>40,443,837</b>                      |



**Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

**11. Angazhime dhe detyrime të konstatuara****Ligjore**

Në rrjedhën normale të biznesit, Fondi mund të përfshihet në kërkesa të ndryshme dhe në veprime juridike. Sipas mendimit të drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt material në pozicionin financiar të Fondit ose ndryshime në aktivet neto përveçse kur është parashikuar në pasqyrat financiare.

**12. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar ose ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër për marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin. Një numër transaksionesh janë të lidhur me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe bilanceve të mbetura në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

| <b><i>Vlera neto e mjeteve të kontributeve të punëdhënësit</i></b> | <b>2017</b> | <b>2016</b> |
|--|-------------|-------------|
| Punonjësit e Sigal Uniqa Group Austria sh.a.                       | 88,311,508  | 59,316,896  |
| <b><i>Tarifat e menaxhimit paguara Shoqërisë Administruese</i></b> |             |             |
| Sh.a.f.p. Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.                     |             |             |
| - Paguar   | 24,802,016  | 15,116,203  |
| - Detyrime   | 2,196,446   | 1,687,891   |

---

**13. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që kërkojnë rregullim ose paraqitje në këto pasqyra financiare.